



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE  
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2024

**Shtojca 13**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

**11.10.2024**

Drejtuar: **OPERATORIT EKONOMIK “NIEM”**

**Korce QENDER BILISHT BITINCKE Autostrada BilishtKorce, Km. i 3, Bitincke.**

Procedura e prokurimit: **E Kufizuar- Shërbime- mbi kufirin e larte monetar -Marrëveshje kuadër- prokurim me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-10914-06-24-2024**

Numri i referencës së Lotit 2: **REF-10922-06-24-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Jugor Gjirokastër (ndarë në 11 lote)”**

**Loti 2: Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Përmet - Çarshovë + rruga Çarshovë - tre urat (doganë) 34.8 km, me vlerë totale 109,375,238 (njëqind e nëntë million e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH. / Në Euro 1,090,916 (një million e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) Euro pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **48 muaj**

Publikimet e mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Data 1 Korrik 2024, Nr. 34**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

- **Çmimi** pikët [0 - 60]
- **Përvoja në shërbime të ngjashme** pikët [0 - 20]
- **Cilësia** pikët [0 - 15]
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** pikët [0 - 5]

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

**1. OE “I.D.K – KONSTRUKSION” K51408016J**

**2. OE “NIEM” K36609610Q**

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar ofertuesi me vlerën përkatëse të ofruar:

**1. OE “NIEM” sh.p.k K36609610Q**

Vlera: **104,867,596** (njëqind e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **290.85**

**OE “I.D.K – KONSTRUKSION” K51408016J**

Vlera: 0

Totali i pikëve të marra: 0

Janë skualifikuar Operatorët Ekonomikë të mëposhtëm:

**Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k J93711608Q**

**Skualifikohet**, pasi nuk përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit, sipas parashikimit të nenit 76, të LPP-së si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Nuk ka plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.1, pikës 2.3.3, pikës 2.3.4, pikës 2.3.5, pikës 2.3.6, pikes 2.3.7, pikes 2.3.8, pikes 2.3.9.**

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 11.

**Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.2.1** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).*

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023.

**Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.*

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 1.**

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 11, Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5, Listën e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 6 dhe Formularin e Kërkesës për pjesëmarrje, sipas Shtojcës 1.*

**Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Rroku GUEST” & “DEHA 2010” sh.p.k.**

**K 87921701 H & L03425410B**

**Skualifikohet**, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Operatori Ekonomik “Rroku GUEST” sh.p.k nuk përmbush kriteret kumulative referuar nën-pikës 2.2.1 e seksionit 2.2 dhe nën-pikës 2.3.2 të kritereve të veçanta për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. “Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.”**

Referuar vërtetimit për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të deklaruara nga OE “Rroku GUEST”, ku vlera më e lartë e xhiros është viti 2023 me të ardhura 189,125,479 dhe kritereve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nën-pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nën-pika 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik

*ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.*”, ku vlera e llogaritur që duhet të plotësojë operatori ekonomik duke marrë në konsideratë % e bashkëpunimit si dhe vlerën e fondit limit për lotet e përmendur në deklaratën kumulative është 254,495,805, **Kriteri konsiderohet i papermbushur nga operatori ekonomik.**

Referuar Procesverbal - Tipi i kontratës – Shërbime- për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, pjesë e DT, është llogaritur kategoria që duhet të përmbaje Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, si dhe duke marrë në konsideratë % e bashkëpunimit të OE. Vlera e llogaritur në kumulative e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv është 22,974,805 me kategori NS-7- B.

Në zbatim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit *“Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpika 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.”*, **Kriteri konsiderohet i papermbushur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” sh.p.k pasi kategoria në licensë është NS-7/A.**

#### **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “TEA-D” & “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k.**

**K32522629L & M03116403L**

**Skualifikohet**, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Bashkimi i operatoreve ekonomik **“TEA-D” & “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k.** nuk përmbush kriterin 2.3.1 **“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit”.

Operatori ekonomik **“TEA-D” sh.p.k.** nuk përmbush shërbim të ngjashëm (mirembajtje rutine me performance në rrugë) e cila ze 60% të vlerës së kontratës sipas përcaktimit në specifikimet teknike si dhe në preventivat e publikuara mirembajtja rutine me performance të cilat prevalojnë në këto kontrate shërbimi duke zënë minimalisht 60 % të vlerës së kontratës, Vlera e shërbimit të ngjashëm të paraqitura sipas zerave të ngjashëm me preventivin mirembajtje rutine me performance në rrugë janë në vlerën 11,460,164.1 lek, kundrejt vlerës 19,687,542.84 që duhet të plotësojë operatori sipas përqindjes në kontratën e bashkëpunimit. Bashkimi i operatoreve ekonomik **“TEA-D” & “AIDA CONSTRUCTION” sh.p.k** përmbush vlerën 40 % të punimeve të rehabilitimit. Kriteri konsiderohet i papermbushur pasi nuk plotësoni vlerën e shërbimit të ngjashëm.

**Operatori ekonomik “I.D.K – KONSTRUKSION”**

**K51408016J**

**Skualifikohet**, pasi nuk ka paraqitur oferte ekonomike në fazën e dytë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se **Operatori Ekonomik “NIEM” SHPK**, me Nr. Nipti: **K36609610Q** dhe adresë: **Korce QENDER BILISHT BITINCKE Autostrada BilishtKorce, Km. i 3, Bitincke.**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme): **104,867,596** (njëqind e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **290.85**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gentian Gjyli**